



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE TË KZAZ-VE PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirim dhe emërimin e disa anëtarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 3589 prot., datë 14.05.2019, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.27, Qarku Tiranë.
- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.28, Qarku Tiranë.
- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.56, Qarku Fier.
- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.57, Qarku Fier.
- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.58, Qarku Fier.
- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.59, Qarku Fier.
- lirim dhe emërim të dy anëtarëve të KZAZ nr.77, Qarku Gjirokastrë.
- lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.84, Qarku Vlorë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesat dhe propozimet e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e gjen në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.



Nr. 348 i Vendimit Data 15.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e disa anëtarëve të KZAZ-ve
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ-ve sipas kërkesave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.1.
2. Të emërojë anëtarët e KZAZ-ve sipas kërkesave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

